

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga dënoi me 81 vite burg Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, veterani i UÇK për Report Tv: S'kem i për t'ja falur Europës, duhet të burgoseshin kriminelët serbë, jo ne! - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/haga-denoi-me-81-vite-burg-thacin-krasniqin-veselin-dhe-selimin-veterani-i-uck-per-report-tv-skemi-per-tja-falur-europes-duhet-te-burgoseshin-kriminel-et-serbe-jo-ne
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:01:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:00:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d34cc85a7657da4a006d240b18e173da138613176f62e533393a21f8b584785
TEKSTI	fad11f04611d302735cfec649b2e39c7407a55a7bbf0226397c04b568b2d8ecf
PAMJA	ed6d333c76cf54a3c0ef57927395e9d04c7ebfbacc0df87f17d5de0c760a2063

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c51c29ad85af5c0dd803892d9e3452ae5bc7ef805b90a802737959b42913b9ce
E MËPARSHMJA	4100e5b19c22b7a5bbb77dd30b78ca2f026befc03c3b2f2a6683b76b01a1be8e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c51c29ad85af5c0dd803892d9e3452ae5bc7ef805b90a802737959b42913b9ce>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



FBI 'zbarkoi' nesër në Tiranë, 235 pjesëmarrës të agjencive ligjzbatuese nga Europa dhe SHBA mbledhen në kryeqytetin e Shqipërisë

Kosova & Rajoni

Lajme nga emisionet

Haga dënoi me 81 vite burg Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, veteranin i UÇK për Report Tv: S'kemi për t'ja falur Europës, duhet të burgoseshin kriminelët serbë, jo ne!

Veterani i UÇK-së, Agim Pllashniku, u bëri thirrje shqiptarëve që të shkaktojnë trazira në të gjithë Ballkanin, derisa 4-ish krerët e UÇK-së të lirohen.

■ Paradoksi me rastin e Hashim Thaçit! Serbia e dënoi me 10 vite si 'terrorist' në vitin 1997, 29 vjet më vonë Haga thuashe ia trefishoi dënimin për krime lufte



Redaksia

16 Shtator, 17:56 | Përditësimi: 16 Shtator, 20:48

Share Tweet

A A

Agim Pllashniku, veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka reaguar ashpër ndaj vendimit të sotëm të Dhomave të Specializuara në Hagë, që dënuan me 81 vite burg në total 4 ish-krerët e UÇK-së.

Në një lidhje për emisionin 'Studio Live' me gazetarin Ermal Qori në Report Tv, Pllashniku e cilësoi vendimin e sotëm të Hagës të gabuar dhe akuzoi Europën për padrejtësi ndaj shqiptarëve.

Pllashniku shtoi se shqiptarët nuk duhet t'ja falin Europës këtë gabim që sipas tij kanë bërë ndaj 4 ish-krerëve të UÇK-së, teksa tha se priste që 4 ish-liderët e UÇK të shpalleshin të pafajshëm.



LEXO EDHE:

Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

"Sot në emër të popullit duheshin shpallur të pafajshëm katërshja më e madhe themeluese e UÇK-së. Haga ka gabuar sot rëndë. Gjithmonë kur kanë qenë vendime të mëdha, Europa ka gabuar me ne. Këtë idhnim që na i ka bërë ne veteranëve të luftës, nuk do ia falim ne Europës qysh ja kemi falur më herët. Ne kemi pritur një vendim që t'i shpallte të pafajshëm", tha mes të tjerash Pllashniku.

Më tej Pllashniku u bëri thirrje shqiptarëve që të shkaktojnë trazira në Ballkan, derisa themeluesit e UÇK-së të lirohen.

Për Pllashnikun, janë serbët ata që duhet të dënohen, të cilët kanë kryer krime lufte, duke vrarë gra e fëmijë të pafajshëm në Kosovë.

"Prej këtij momenti, ne veteranët e luftës bëjmë edhe një thirrje që të trazojmë gjithë Ballkanin, ose të lëshojnë themeluesit e UÇK-së. Nëse janë fajtor ata, jemi edhe ne fajtorë. Në vend që të dënohen serbët që kanë bërë krime në Kosovë, kanë prerë fëmijë e kanë dhunuar gra, po dënoheni ne që kemi bërë luftë çlirimtare", tha mes të tjerash Agim Pllashniku, veteran i UÇK", shtoi Pllashniku.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vite burg, Kadri Veseli me 18 vite dhe Rexhep Selimi me 13 vite burgim, pasi u shpallën fajtorë për krime lufte.

R.Xh/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Agim Pllashniku Gjyqi ndaj UCK ne Hage hage hashim thaci Jakup Krasniqi kadri veseli rexhep selimi BE



Sa e vlerësoni këtë artikull?



5.0 / 5 (1 vlerësim)

Komente

Komento



Ndalohej repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpalojet flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)

20 Shtator, 21:28



Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)

20 Shtator, 16:25



Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

20 Shtator, 15:11



Verdikt i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interperancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjyqimit?

20 Shtator, 13:40



Derisa të jemi kaq të këqinj dhe kundër njëri-tjetrit përballë të huajve...



Alba Malltezi

20 Shtator, 12:32



Protesta nacionaliste kundër emigracionit në Hagë del jashtë kontrollit! Përplasje të dhunshme mes demonstruesve dhe policisë

20 Shtator, 11:24



A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Pandeli Majko: Ku gabuam...?



Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.